



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA –SUHAREKË  
MUNICIPALITY SUHAREKË  
OPSTINA SUVAREKA



## Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

06.Nr.1070

Suharekë, 09.06.2023

Konform nenit 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 44 parag.1.1 dhe nenit 84 parag.1 dhe 2 të LPPA-së Nr.05/L-031, nenit 12 dhe 13 të Rregullorës për ndarjen e subvencioneve të KK Suharekë, 01.Nr.16.58-6, me autorizimin e Kryetarit të komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Komuna Suharekë, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohen kërkesa, të paraqitura për sëmundje të rëndë dhe gjendje të rëndë ekonomike në bazë të listës së kërkesave të specifikuara si në dispozitiv të këtij vendimi për ndihmë të njëhershme në të holla sipas shumave të përcaktuara veç e veç për ndihmë momentale, gjithësejt: **14.600.00 €**.
- II. Paguesa e ndihmës bëhet nga subvencionet e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale K.Suharekë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Për sëmundje të rëndë dhe gjendje të rëndë ekonomike, palët kanë paraqitur kërkesa për ndihmë momentale si që janë specifikuar në dispozitiv të këtij vendimi. Komisioni ka shqyrtuar së bashku kërkesat e ngjajshme të palëve bazuar në nenin 84 parag.1 dhe 2 të LPPA-së, duke konstatuar se kërkesat janë të bazuara konform nenit 12 të Rregullorës për ndarjen e subvencioneve, njëkohësisht propozon shumat për ndihmë të njëhershme në të holla për secilën kërkesë veç e veç të specifikuara dhe u miratuan si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përfitues të këtyre subvencioneve janë në total 65 persona, prej të cilëve 33 femra dhe 32 meshkuj.

Gjithsej : pagesa në shumën prej **14.600.00 €**.

Ekzekutimi i pagesës së ndihmës bëhet nga subvencionet e kësaj drejtorie.

Nga si u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**DREJTORI**



**Ma. Sc. Besa Kuqi**

Të njoftohen:

Pala

Evidenca

Sherbimi Financiar